



Dokumenti Analiza Vjetore e Gjykatës përfaqëson në mënyrë të përmblodhur analizën e punës së kryer dhe performancën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjatë vitit kalendarik 2023, parashton njëkohësisht problematikat e konstatuara gjatë këtij viti përsa i takon funksionimit të institucionit në tërësi, si dhe sfidat për të ardhmen.

Tema të analizuar:

- I. Hyrje**
- II. Veprimtaria Gjyqësore**
 - 1. Ngarkesa dhe lloji i çështjeve gjyqësore**
 - 2. Tendenca e ngarkesës me çështje**
 - 3. Likujdimi/përfundimi i çështjeve**
 - a. Çështjet penale themeli.
 - b. Kërkesa penale.
 - c. Kërkesa penale në seancë paraprake.
 - d. Çështjet civile.
 - e. Kërkesat për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes.
 - f. Kërkesat civile.
 - 4. Ngarkesa me çështje për gjyqtar**
 - 5. Shpejtësia në gjykim**
 - 6. Heqjet dorë nga gjykimi i çështjeve**
 - 7. Përrjashtimet e gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve**
- III. Menaxhimi i Lëvizjes së Çështjeve Gjyqësore**
 - 1. Mbikqyrja e progresit të çështjeve.
 - 2. Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore.
- IV. Menaxhimi administrativ i gjykatës**
 - 1. Organika dhe burimet njerëzore.
 - 2. Teknologjia e informacionit.
 - 3. Programi i transparencës.
 - 4. Ofrimi i shërbimeve nga administrata gjyqësore.
 - 5. Aksesit, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median.
 - 6. Çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë.
 - 7. Administrimi i fondeve publike.
 - 8. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

I. HYRJE

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj të ftuar, kolegë dhe pjesëmarrës në këtë analizë!

Analiza e gjykatës, është një moment reflektimi mbi punën e gjykatës, arritjet dhe mangësitë. Ajo shërben si një mundësi për secilin prej nesh, për të reflektuar mbi punën dhe rezultatet e arritura në vitin e kaluar, si dhe për të shprehur mendime se si ne të gjithë së bashku mund të kontribuojmë në forcimin e shtetit të së drejtës në komunitetin ku jetojmë dhe më gjerë.

Analiza vjetore e punës së gjykatës, është një moment i rëndësishëm reflektimi mbi punën e bërë dhe mbi masat që duhen marrë dhe hapat që duhen ndjekur në drejtim të përmirësimit të saj në të ardhmen.

Puna e një institucioni si gjykata është e vlerësueshme me elementë të tillë si volumi, cilësia dhe shpejtësia e gjykimit nga ana e gjyqtarëve që janë pjesë përbërëse e saj.

Për këtë arsye, më poshtë po paraqesim të dhënat që pasqyrojnë punën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me qëllim për të pasqyruar, trajtuar dhe ofruar zgjidhjen për probleme të ndryshme.

Bazuar në VKM nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ndryshuar, Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”, Vendimin nr. 131, datë 28.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për Fillimin e Funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, ne datën 01.05.2023 ka filluar funksionimin Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ndërpret veprimtarinë.

Kompetencat aktuale tokësore për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier përfshijnë këto bashki: Fier, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec dhe Divjakë. Vendndodhja e gjykatës është në qytetin e Fierit. Kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë të njehsuara me strukturën administrative tokësore të Qarkut Fier.

Infrastruktura e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, avantazhet: Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ndodhet në qendër të qytetit të Fierit. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ushtron funksionin e saj afër Gjykatës. Disavantazhet: Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka 14 zyra gjyqtarësh dhe 8 zyra të administratës; si dhe 5 salla gjyqi (2 penale dhe 3 civile). Gjykata e ndan hapësirën e ndërtesës me Prokurorinë dhe me Shërbimin e Përmbartimit. Aktualisht, kjo gjykatë nuk i përmbush standardet që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit ex-parte, megjithatë hapësira e shërbimit për publikun është në përputhje me standardet e kërkuara.

Burgjet/Strukturat e tjera të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier përfshin një institucion për vuajtjen e dënimit penal, IEVP Fier, me një distancë të përlllogaritur prej 4 km larg nga gjykata.

Gjykata ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 21 gjyqtarë ne organike për të respektuar mesataren në rang kombëtar prej 429 çështje në gjykatat e rretheve gjyqësore.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka në organikën e saj 20 gjyqtarë dhe një Kryetar. Viti 2023, e gjeti Gjykatën me 9 gjyqtarë, pasi 2 gjyqtare ishin me leje të papaguar nga KLGJ-ja. Gjatë gjysmës së parë këtij viti, emerimit në Gjykata të tjera janë larguar edhe 6 gjyqtarë. Ndërsa që prej 18.10.2023, veprimtaria gjyqësore në Gjykatën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ushtrohet efektivisht nga vetëm 14 gjyqtarë.

Në këte gjykatë, për vitin e kaluar kanë funksionuar seksionet penale dhe civile, gjithashtu në mbështetje të nenit 28§2 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar me ligjin nr.37/2017, dhe Udhëzimit nr.79, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Vendim të Këshillit të Gjykatës, janë caktuar si gjyqtarë të specializuar për çështjet penale me të mitur, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin, ose të mitur viktimë nga vepra penale konkretisht të gjyithe gjyqtaret e seksionit penal.

II. VEPRIMTARIA GJYQËSORE

1. NGARKESA DHE LLOJI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.

Gjatë vitit 2023 në Gjykatën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë paraqitur për shqyrtim **në total 9196 çështje** (të natyrës penale, penale-administrative, civile dhe familjare). Në numrin e çështjeve për shqyrtim përfshihen **1868** çështjet e mbartura nga viti 2022 dhe **7328** çështje të regjistruara të reja në vitin 2023.

Nga totali i çështjeve për shqyrtim, për **6614** çështje ka përfunduar gjykimi në vitin 2023, ndërsa **2543** çështje kanë mbetur të papërfunduara dhe janë mbartur për gjykim në vitin 2024, sipas tabelës 1.

Tabela.1

Volumi i Çështjeve viti 2023	Numri
Çështje të gjykuara	6614

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

Çështje të mbartura në 2023	1868
Totali i çështjeve për shqyrtim	9196
Çështje të regjistruara të reja në 2023	7328

Nga totali i çështjeve të gjykuara rezulton se:

1. **Në lëndë penale**, ka përfunduar gjykimi për një total prej **3899** çështje. Në këtë numër përfshihen çështje penale themeli, penale të posaçme, kërkesat penale-administrative, kërkesa penale gjatë hetimeve paraprake, në seancë paraprake dhe kërkesa penale gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit.
2. **Në lëndë civile dhe familjare** ka përfunduar gjykimi për **3463** çështje.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, rezulton se ngarkesa me çështje gjyqësore është e mesatare për organikën prej vetëm 14 gjyqtarë (aktualisht) të gjykatës.

Numri i çështjeve penale është i lartë për shkak se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, mbulon kërkesat e të dënuarve të IEVP-së Fier.


2. TENDENCA E NGARKESËS ME ÇËSHTJE.

Për të parë tendencën e ngarkesës le t'i referohemi tabelave të çështjeve për 5 vitet e fundit, duke bërë edhe krahasimet përkatëse:

Tabela.2

	Çështje të regjistruara për gjykim	Çështje të gjykuara	Çështje të mbartura
Viti 2023	7328	6614	2582
Viti 2022	5942	5732	1317
Viti 2021	6471	6642	1121
Viti 2020	5531	5196	1316
Viti 2019	6679	6695	1007

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023




Numri i çështjeve të regjistruara të reja (duke mos përfshirë të mbarturat nga viti i mëparshëm) në 5 vitet e fundit:

Tabela.3

Çështje të rregjistruara në total (penale dhe civile)				
Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
6679	5531	6471	5942	7328


ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023



Numri i çështjeve të gjykuara në vitet e fundit:

Tabela.4

Çështje të gjykuara penale dhe civile				
Vitit 2019	Vitit 2020	Vitit 2021	Vitit 2022	Vitit 2023
6695	5196	6642	5732	6614




Të dhënat statistikore për tendencën e ngarkesës me çështje të gjykuara për vitet e fundit, tregojnë se në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 ka një rritje të çështjeve të përfunduara, për shkak të bashkimit të gjykatave si edhe numrit të shtuar gjyqtareve në 14 gjyqtarë efektivë nga 21 gjyqtarë që është organika gjithsej. Ngarkesa vijon të mbetet normale për numrin e gjyqtarëve efektivë në gjykatë (14 të tilla) në fund të vitit 2023.

3. LIKUJDIMI/PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE.

Numri i çështjeve të mbartura në fund të vitit, për vitin pasardhës, në katër vitet e fundit:

Tabela.5

Çështje të mbartura në fund të vitit, për vitin pasardhës (penale dhe civile)				
Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1007	1316	1121	1868(Fier+Lushnje)	2582



Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se në fund të vitit 2023, numri i çështjeve të mbartura është rritur me rreth 38% me vitin paraardhës.

Rritja e numrit të çështjeve të mbartura në fund të vitit 2023, lidhet me largimet e 6 gjyqtareve ne gjashtemujorin e pare ne fillim te vitit 2023, bashkimin e gjykatave si edhe ardhjen e 6 gjyqtareve te rinj ne daten 18.10.2023 te rinj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier

Norma e zgjidhjes/likuidimit të çështjeve “*Clearance rate*”, (që është raporti i thjeshtë i dalë nga pjestimi ndërmjet çështjeve të zgjidhura me çështjet e reja të regjistruara brenda një periudhe vjetore, i shprehur në përqindje), në vitin 2023 është **90 %**, pra më e ulët se e vitit 2022, ku kjo vlerë ishte **96.4 %**. Norma e zgjidhjes së çështjeve tregon nëse gjykata ka qënë e aftë të zgjidhë më shumë çështje se sa janë regjistruar për shqyrtim dhe për rrjedhim nëse edhe një pjesë e çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm janë zgjidhur. Norma e likuidimit afer 100% është tregues pozitiv për likuidimin e çështjeve si Gjykatë. Vlera 90 % e *Clearance rate* për vitin 2023 sigurisht që konsiderohet pozitive per numrin e lartë te çështjeve të përfunduara prej 14 gjyqtarësh.

Në fakt, konstatohet që norma e likuidimit të çështjeve penale është më e lartë se norma e likuidimit të çështjeve civile, përkatësisht **101 %** dhe **78 %**. Megjithëse këto norma mund të konsiderohen të pranueshme, kujdes i veçantë nevojitet në menaxhimin më aktiv në qarkullimin e çështjeve penale, sidomos në trajtimin e çështjeve Penaleve të Veçanta dhe çështjeve administrative penale në fazën e ekzekutimit, gjithashtu edhe trajtimin te dosjeve gjyqesore civile qe kane mbi 2 vjet ne gjykim, kryesisht dosje gjyqesore te rishortuara prej gjyqtareve te larguar. Gjithsesi, duke patur parasysh edhe ngarkesën me çështje të regjistruara të reja në vitin 2022, si dhe largimin e disa gjyqtarëve gjatë vitit, ky tregues i këtij viti mund të konsiderohet pozitiv.

- Për të gjitha çështjet e shqyrtuara në gjykatë në vitin 2023, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “*Clearance rate*” është **90 %**.

$$\text{Clearance rate}_{total} = \frac{6614[\text{numri i çështjeve të gjykuara}]}{7328 [\text{numri i çështjeve të reja për 2023}]} \times 100\% = 90 \%$$

a. Çështje penale themeli.


Nga **813** çështje të gjykuara të natyrës penale themeli, rezultojnë se **799** prej tyre janë gjykuar me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, ndërsa **13** çështje penale janë gjykuar me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë.

Pas muajit Gusht të vitit 2017, pra edhe në këto vite në vazhdim, rezultojnë një numër i vogël çështjesh të gjykuara me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë, për shkak të ndryshimit në nenin 13 të K.Pr.Penale, që lidhet me rritjen e maksimumit të dënimit penal nga 7 vjet në 10 vjet, për çështjet që gjykohen me tre gjyqtarë.

Tabela.7

Nr.	Natyra e çështjeve	Numri i çështjeve në vitin 2019	Numri i çështjeve në vitin 2020	Numri i çështjeve në vitin 2021	Numri i çështjeve në vitin 2022	Numri i çështjeve në vitin 2023
1	Penale themeli	494	465	658	512	815
2	Kërkesa penale, kërkesa administrative-penale etj.	3074	2428	2662	2281	3088

Në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës në çështjet e natyrës penale themeli, rezultojnë se gjatë vitit 2023, janë dënuar në total 815 persona, 29 femra dhe 786 meshkuj, nga të cilët 8 të mitur në konflikt me ligjin (meshkuj). Për 38 persona, gjykata ka dhënë vendim pafajësie, për 38 persona, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes penale.



ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

Gjatë vitit 2023, në Gjykatën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë gjykuar 8 të mitur në konflikt me ligjin. Në mbështetje të nenit 28/2 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të miratuar me ligjin nr.37/2017, në zbatim të Udhëzimit nr.79 datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e gjyqtarëve, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale” janë caktuar gjyqtarët e specializuar për çështjet penale me të mitur, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin, ose të mitur viktimë nga vepra penale.

Në tabelën që pason, po paraqesim të dhëna statistikore për numrin e çështjeve të gjykuara në bazë të figurës së veprës penale:

Tabela.8

Nr.	Figura e veprës penale	Neni i K.Penal	Numri i çështjeve të gjykuara në vitin 2019	Numri i çështjeve të gjykuara në vitin 2020	Numri i çështjeve të gjykuara në vitin 2021	Numri i çështjeve të gjykuara në vitin 2022	Numri i çështjeve të gjykuara në vitin 2023
1	Vrasje me dashje	Neni 76 i K.Penal	3	1	1	4	1
2	Vrasje me paramendim	Neni 78 K.Penal	1	1	1	5	5
3	“Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, “vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”	Neni 79, 79/c të K.Penal		3	3	1	7
4	Plagosje e rëndë me dashje	Neni 88 i K.Penal	3	2	4	1	5
5	Vjedhja	Neni 134/1, 2 i K.Penal	42	30	41	24	36
6	Vjedhja me dhunë	Neni 139 i K.Penal	3	4	1	2	1
7	Falsifikimit të dokumenteve	Neni 186 i K.Penal	11	11	3	8	6
8	Armëmbajtje pa leje	Neni 278/2, 4, 5 i K.Penal	8	12	11	8	9

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

9	Shpërdorimi i detyrës	Neni 248 i K.Penal	2	4	2	2	4
10	Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve	Neni 283/1, 2 i K.Penal	30	17	32	27	46
11	Kultivimi i bimëve narkotike	Neni 284/1, 2 i K.Penal	2	7	35	22	21
12	Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	Neni 290 i K.Penal	18	20	21	12	26
13	Kanosja	Neni 84 i K.Penal	4	2	9	2	4
14	Plagosje e lehtë me dashje	Neni 89 i K.Penal	9	8	18	9	22
15	Përndjekja	Neni 121/a i K.Penal	5	5	12	7	7
16	Dhuna në familje	Neni 130/a i K.Penal	47	63	77	61	94
17	Vjedhja e energjisë elektrike	Neni 137/1, 2 i K.Penal	9	7	8	16	9
18	Fshehja e të ardhurave	Neni 180 i K.Penal	3	2	2	3	3
20	Ndërtim i paligjshëm	Neni 199 i K.Penal	26	22	31	22	57
21	Drejtimin të mjetit në mënyrë të parregullt	Neni 291 i K.Penal	113	110	139	116	259
22	Mashtrimi	Neni 143 i K.Penal	10	8	8	8	4
23	Vetëgjyqësia	Neni 277 i K.Penal	3	8	15	10	6

Nisur nga të dhënat e mësipërme, rezulton se kriminaliteti në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kryesisht karakterizohet nga veprat penale me rrezikshmëri të ulët. Veprat penale më të përhapura në vitin 2023, janë veprat penale të “Drejtimin të mjetit në mënyrë të parregullt” pa leje drejtimi ose në gjendje të dehur, ”Ndërtim i paligjshëm”. “Dhuna në familje”, “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” si edhe e “vjedhjes”.

Këtë vit, vërehet një rritje e numrit të veprave penale. Konkretisht, rritje e dukshme veprës penale “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*” duke e krahasuar duke e krahasuar me vitet 2019, 2020, 2021, 2022. Për rrjedhim, ka nevojë për më shumë ndërgjegjësim dhe parandalim të kësaj veprë penale nga institucionet përgjegjëse. Ndërsa përsa i përket veprës penale të “*Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor*” vërehet perseri një rritje krahasuar me vitin e kaluar në përhapjen e kësaj veprë krahasuar me vitet paraardhëse.

Shqetësuese gjatë vitit 2023, përbën vepra penale e “*Dhunës në familje*”, 94 çështje, duke e bërë vitin 2023, si vitin me treguesin më negativ pas viteve 2022, 2021, 2020 dhe 2019 për sa i përket kësaj veprë penale, në vitet e fundit. Ky është tregues domethënës i problematikës dhe fenomenit në rritje të dhunës në familje. Vërehet se viktimat e dhunës në familje në një numër të konsiderueshëm rastesh kërkojnë urdhër mbrojtje, por jo ndjekje penale.

Në vitin 2023, gjithashtu, ka një ulje dhe të veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*” dhe “*Kultivimi i bimëve narkotike*” krahasuar me vitin 2022. Konkretisht, për veprën penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*” nga 27 raste (në 2022), në 46 raste (në 2023), përkatësisht një rritje me 19 raste. Për veprën penale të “*Kultivimit të bimëve narkotike*” nga 22 raste (në 2022), në 21 raste (në 2023), përkatësisht një ulje me 1 rast. Treguesi i vitit 2023, është më larte treguesve të këtyre veprave penale të viteve 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Ndërsa rastet e veprave penale me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore janë të pakta dhe në to mbizotëron vepra penale e “*vrasjes në rrethana cilesuese*”, neni 79 i K. Penal dhe “*vraska për shkak të marrëdhënieve familjare*” neni 79/a i Kodit Penal me një rritje të krahasuar me vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Në tabelën 9 pasqyrohen llojet e dënimeve të dhëna nga gjykata:

Tabela.9

Dënimi	Numri i personave të dënuar në vitin 2022
Me gjobë	44
Burgim deri në dy vjet.	204
Burgim nga 2 deri në 5 vjet.	44
Burgim nga 5 deri në 10 vjet.	7
Burgim nga 10 deri në 25 vjet.	11
Burgim nga 25 deri në 35 vjet	3
Burgim i përjetshëm	2
Aplikimi i nenit 59	454
Aplikimi i nenit 59/a	1
Aplikimi i nenit 63	44

**ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023**

Totali	815
---------------	------------

Rezulton që numri i personave të dënuar gjatë 2023 është 815, 257 persona më shumë se në vitin 2022. Gjatë vitit 2023 rezultojnë të jenë dënuar 2 persona me burgim të përjetshëm. Në vitin 2023 numri i personave të dënuar me gjobë është 15 persona më shumë se një vit më parë. Dënimi më i aplikuar nga gjykata është dënimi me **burgim deri në 2 vjet**, i cili referuar të dhënave statistikore për figurat e veprave penale, përputhet me rrezikshmërinë e ulët të veprave penale më të përhapura në qarkun e Fierit. Por, këtë vit, si dhe në vitin 2022, bie në sy aplikimi i gjerë i nenit 59 dhe 63 të K.Penal, si dënime alternative, duke pezulluar dënimin me burgim dhe vënien në provë, i ndjekur nga kryerja e një pune me interes publik pa shpërblim.

Nga analiza e të dhënave të vitit 2023, rezulton se numri i çështjeve që janë shqyrtuar me gjykim të shkurtuar është i konsiderueshëm, ndërsa gjykimi i drejtpërdrejtë është aplikuar në 19 çështje. Me ndryshimet me ligjin nr.35/2017 të K.Pr.Penale janë shtuar edhe lloje të tjera të gjykimeve të posaçme si Urdhëri penal dhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë.

b. Kërkesat penale.

Në vitin 2023, në Gjykatën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, janë regjistruar 1135 çështje penale të veçanta të reja dhe kanë perfunduar 1134 çështje. Në këtë grup çështjesh bëjnë pjesë kërkesat e paraqitura nga prokuroria, për vleftësimin e ndalimit apo të arrestit në flagrancë, për caktimin e masave të sigurimit, verifikimit të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, lejimin/vleftësimin e përgjimit, kontrollit të banesës, deklarimit të ikjes, shuarjes së masës së sigurimit, etj.

Ne vitin 2023 janë regjistruar gjithsej 3025 çështje penale administrative dhe ka perfunduar gjykimi për 3088 prej tyre duke mbartur për vitin 2024, 438 kërkesa.

Duke analizuar kërkesat për vleftësim ndalimi apo arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi, rezulton se nga 433 kërkesa të shqyrtuara në total, për 406 prej tyre, gjykata e ka vleftësuar si të ligjshëm ndalimin apo arrestimin e personave të ndaluar/të arrestuar, ndërsa për 27 kërkesa, gjykata ka vendosur vleftësimin e paligjshëm të ndalimit/arrestimit të personave të ndaluar/arrestuar. Në lidhje me masat e sigurimit të vendosura nga ana e gjykatës, që i janë nënshtruar këtyre gjykimeve, për 215 kërkesa të paraqitura nga organi i akuzës është vendosur masa e sigurimit “*arrest në burg*”, për 65 kërkesa është vendosur masa e sigurimit “*arrest në shtëpi*”, për 170 kërkesa është vendosur nga ana e gjykatës masa e sigurimit “*detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, për 3 kërkesa është vendosur nga ana e gjykatës “*moscaktimi i asnjë mase sigurimi*” duke

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

urdhëruar lirimin e menjëhershëm të personave të ndaluar/arrestuar, për 13 kërkesa

Ç Ë S H T J E T	MËNYRA E PËRFUNDIMIT	SHPEJTËSIA E GJYKIMIT
-----------------	----------------------	-----------------------

është vendosur “shtrimi i detyruar në një spital psikiatrik”, për 4 kërkesa është vendosur “ndalimi i daljes jashtë shtetit”.

Tabela. 10

Arrest në burg	Arrest në shtëpi	Detyrim paraqitje	Të tjera	Totali
215 (45.6 %)	65 (13.8 %)	171 (36.3 %)	20 (4.3 %)	471 (100%)

Duke parë shifrat e mësipërme, rezulton se në 46.8 % të rasteve, është vendosur si masë sigurimi nga ana e gjykatës ajo e “arrestit në burg”.

Në të gjitha gjykimet e kërkesave gjatë fazës së hetimeve paraprake është respektuar grafiku i gadishmërisë mujore me bazë mbiemrin e çdo gjyqtari, një kopje e të cilit i dërgohet edhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Për çdo rast është patur në prioritet shqyrtimi i kërkesës për të njëjtin procedim nga i njëjti gjyqtar që ka shqyrtuar kërkesën e parë.

c. Kërkesat penale në seancë paraprake.

Pas ndryshimeve, me ligjin nr.35/2017 në K.Pr.Penale, numri i kërkesave të seancës paraprake si kërkesa penale për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kërkesa për pushimin e çështjes penale për krime, vazhdon të jetë i lartë, por gjithsesi në vlera të qëndrueshme, krahasuar me dy vitet paraardhës.

Në vitin 2023 janë paraqitur gjithësej për shqyrtim **1467 kërkesa të seancës paraprake**, nga të cilat kanë përfunduar **1178**, me tregues sipas tabelës së mëposhtme.

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

Të ardhura të reja	Pranuar	Pushuar	Kaluar për gjykim	plotësim hetimesh	Vendosur Moskompetenca	Të tjera	Përfunduar	deri në 1 muaj	mbi 1 muaj
3	5	6	7	8	9	10	11	13	14
1467	34	391	689	49	0	15	1178	244	934

d. Çështjet civile:

Gjatë vitit 2023, janë gjykuar gjithsej **2715** çështje civile, nga të cilat **1734** civile themeli dhe 981 civile pa palë.

Në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, në vitin 2023 janë gjykuar me trup gjykues të përbërë me një gjyqtar **1726** çështje civile dhe me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë janë gjykuar vetëm **8** çështje civile. Numrit të çështjeve që gjykohen me trup gjykues me tre gjyqtarë krahasuar me vitin 2022, është vetëm 7 çështje më shume.

Nga analiza e të dhënave statistikore konstatohet një numër prej **520** çështje civile të pushuara gjatë vitit 2023. Duke u krahasuar me **561** çështje civile të pushuara në vitin 2022. Duket një barazim në vlerë, por është një rënie në vlerë për shkak të uljes së numrit të çështjeve civile të përfunduara në vitin 2023 dhe ceshtjeve te pushuara. Gjithësesi, përqindja e çështjeve civile të pushuara mbetet relativisht e lartë dhe lidhet me mosndërgjegjësimin për plotësimin e elementëve të padisë, mosparaqitja e paditësit/kërkuesit pa shkaqe të arsyeshme dhe tërheqja nga gjykimi i padisë/kërkesës. Rastet e padisë që nuk mund të ngrihet janë të pakta.

Disa nga llojet më të përhapura të çështjeve të natyrës civile të gjykuara gjatë vitit 2022, paraqiten si vijon:

Tabela.12

Lloji i çështjes	Numri i çështjeve në vitin 2019	Numri i çështjeve në vitin 2020	Numri i çështjeve në vitin 2021	Numri i çështjeve në vitin 2022	Numri i çështjeve në vitin 2023

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

Kerkim sendi	31	18	16	28	30
Padi pronësie	41	27	54	34	36
Padi për shkaktimin e dëmit	115	83	62	72	61
Padi kontraktuale	47	35	37	40	26
Kundërshtim të veprimeve përmbarimore	53	34	25	27	43
Konflikte pune, etj.	227	109	78	62	199
Familjare me pale kundërshtare	701	541	739	661	1151
Urdhëra mbrojtje	145	68	173	165	246
Urdhëra të menjëhershëm të mbrojtjes	71	129	81	110	96

Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se edhe për vitin 2023, ngarkesa më e lartë është me çështje familjare dhe pas tyre renditen kërkesat për urdhër mbrojtje. Çështjet familjare me palë kundërshtare gjatë 2023 janë **1151**, ku mbizotërojnë paditë për zgjidhje martesë (**608** të tilla). Paditë për zgjidhje martesë kanë pësuar rritje krahasuar me numrin prej **552** çështje të gjykuara në vitin 2022 në Gjykatën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

e. Kërkesat për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes

Përsa i përket urdhërave të mbrojtjes, numri i përgjithshëm i tyre ka një rritje këtë vit, me 342 kërkesa, kur në 2022 kishim përkatësisht 275. Në fakt, për kërkesat për urdhër të menjëhershëm mbrojtje, rezultojnë 14 më pak se në 2022.

Nga të dhënat e vitit 2019, rezulton se kanë kërkuar lëshimin e urdhërit të menjëhershëm në 71 shtetas, në 2020 kemi përkatësisht 129 kërkesa, ky numër bie në 2021 në vetëm 81 kërkesa, në 2022 janë paraqitur vetëm 110 kërkesa, ndërsa në vitin 2023 janë paraqitur 96 kërkesa.

Ulja e numrit të kërkesave lidhet (por jo vetëm) edhe me pasojat e urdhërit për fillimin e ndjekjes penale. Pothuajse të gjitha kërkesat për urdhër mbrojtje janë

përcjellë/paraqitur nga ana e Komisariateve të Policisë në bazë të formularëve të plotësuar nga kërkuesit.

Tabela.13

Lloji i kërkesave për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes	Numri	Pranuar	Pushuar	Refuzuar
Urdhër i zakonshëm mbrojtjeje	246	141	61	44
Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje	96	68	18	10
Totali	342	209	79	54

Nga analiza e të dhënave, vërehet se numri i rasteve të refuzimit është më i vogël në raport me numrin e rasteve kur gjykata ka pranuar lëshimin e urdhërit të mbrojtjes. Shkaqet e refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes lidhen me mosvërtetimin e ushtrimit të dhunës dhe marrëdhënien familjare sipas përcaktimit në ligj, por konstatohet edhe një numër pothuajse i njejte me refuzimet dhe te pushimeve. Shkaqet e pushimit janë mosparaqitja e viktimës së dhunës në familje në seancë pa shkaqe të arsyeshme, ose heqja dorë nga gjykimi. Praktika mbizotëruese është ajo e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje edhe në rast të mosparaqitjes në seancë, apo tërheqjes së viktimës së dhunës në familje kur janë përcjellë/paraqitur nga ana e Komisariateve të Policisë.

f. Kërkesat civile (çështje civile pa palë kundërshtare), disa lloje:

Tabela.14

Lloji kërkesave civile pa palë kundërshtare	Numri i çështjeve në vitin 2019	Numri i çështjeve në vitin 2020	Numri i çështjeve në vitin 2021	Numri i çështjeve në vitin 2022	Numri i çështjeve në vitin 2023
Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit	912	682	1355	1310	649
Vërtetim fakti i vjetërsisë në punë	173	97	113	26	52
Lëshim autorizimi për të miturin	18	16	49	43	28

Nga analiza e të dhënave, rezulton se nga totali i 981 kërkesave civile për vitin 2023, ngarkesa më e lartë është me kërkesat për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, ku mbizotërojnë kërkesat për tituj ekzekutivë, si faturat e energjisë elektrike, fatura të konsumit të ujit dhe kontratat e kredisë bankare, por gjithsesi, numri i këtyre kërkesave, këtë vit, është me i ulët krahasuar me vitin 2022.

Vërehet rritje e numrit të kërkesave për vërtetimin e faktit të vjetërsisë në punë nga ana e shtetasve që kërkojnë përfitimin e të drejtës për pension, për shkak të mungesës së dokumentacionit të kohës, përkatësisht nga 26 në 52 kërkesa të tilla për vitin 2023.

4. NGARKESA ME ÇËSHTJE PËR GJYQTAR.

Aktualisht trupa gjyqësore nuk është e plotësuar me numrin 21, duke qene se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka në organikën e saj 20 gjyqtarë dhe nje Kryetar. Në fillim të vitit 2023, gjykimet zhvilloheshin nga 8 gjyqtarë, sepse 2 gjyqtare ishin me leje te papaguar nga KLGJ-ja. Gjatë vitit 2023, për arsye të emerimit ne Gjykata të tjera dhe ILD janë larguar edhe 6 gjyqtarë. Kështu, që prej dates 18.10.2023, në Gjykatën e Gjykatës se Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, zhvillimet e seancave gjyqësore, përballohen nga vetëm 14 gjyqtarë. Në këto kushte, mbetet nevojë imediate plotësimi i numrit të gjyqtarëve për shkak të ngarkesës në punë.

Në zbatim edhe të vendimit të KLD-së nr.238/1/a, datë 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore” si edhe Vendimit te KLGJ-se Nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore” çështjet e pushuara dhe çështjet për të cilat është vendosur “Kthim Aktesh”, kur janë riparuar për shqyrtim në gjykatë, i kanë kaluar automatikisht të njëjtit gjyqtar që i ka pushuar më parë. Gjithashtu, jane respektuar ne menyre rigoroze vendimet e mesiperme ne lidhje me ndarjen e ceshtjeve ne short si edhe eshte rritur transparenca e ketij procesi. Çështjet, sipas te dhenave statistikore jane shperndare ne menyre perafersisht te barabarte per te gjithë gjyqtaret. Diferenca justifikohen duke patur parasysh numrin e ceshtjeve te regjistruara gjate gadishmerise se secilit gjyqtar qe mund te kete qene jo i barabarte. Per masat e sigurimit dhe kerkesat gjate hetimit paraprak nga Zv. Kryetarja e Gjykatës, ne zbatim te kompetencave ligjore eshte bere sistematikisht planifikimi i gadishmerise se gjyqtareve sipas grafikut javor per shqyrtimine ceshtjeve te natyres urgjente.

Të dhënat statistikore për ngarkesën e çdo gjyqtari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier gjatë vitit 2023 sipas numrit të çështjeve të gjykuara janë:

Tabela.15

Nr.	Gjyqtar	Numri i çështjeve të përfunduara, viti 2022	Numri i çështjeve të përfunduara, viti 2023
1	Alfred Konomi	1057	982
2	Ejona Lazellari	44	128


**ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023**

3	Erlanda Agaj	998	148
4	Marsela Dervishi	304	0
5	Matilda Shalla	270	0
6	Olkeda Lice	581	527
7	Sonila Hoxha	1058	462
8	Taulant Banushi	880	166
9	Dajana Ndreja	142	492
10	Gladiola Bregu	136	524
11	Nertil Dushku	153	493
12	Rudi Laze	140	483
13	Arjeta Lika	701	32
14	Ersida Bajgora	529	875
15	Miranda Nakaj	695	857
16	Esmeralda Ceka	616	133
17	Dorina Alushi	0	53
18	Juliana Pjetri	0	45
19	Genci Busho	0	74
20	Klodiana Kryeziu	0	46
21	Noel Veizi	0	54
22	Vladimir Cjapi	0	82
		8304	6656

Në këtë ngarkesë është llogaritur edhe prania si anëtar, në gjyqet që zhvillohen me tre anëtarë.

Në vijim është paraqitja grafike e shpërndarjes së numrit të çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2023:

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023



Bie në sy numri i lartë i çështjeve të përfunduara në 2023 nga gjyqtarët: Alfred Konomi, Ersida Bajgora, Miranda Nakaj dhe Olkeda Lice (me 50% ngarkesë për shkak të detyrës si Zv.Kryetare), por edhe gjyqtarët e tjerë për çështjet e gjykuara, kanë kaluar normën vjetore të një gjyqtari, 429 çështje.

Nga analiza e të dhënave, evidentohet fakti se ngarkesa e gjyqtarëve me çështje plotëson parametrat e vendosura në vendimin e KLGJ-së për kriteret matëse të vlerësimit të veprimtarisë së gjyqtarëve, dhe madje e tejkalon dukshëm atë ngarkesë. Gjykata ka një ngarkesë pune të mjaftueshme për të justifikuar 21 gjyqtarë në organike për të respektuar mesataren në rang kombëtar prej 429 çështje në gjykatat e rretheve gjyqësore.

Bazuar në një llogaritje mesatare të ngarkesës për gjyqtar, duke pjestuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2023 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës (duke futur edhe koeficientin për muajt që kanë punuar gjyqtarët e larguar¹), rezulton një numër mesatar prej 660 të çështjeve të reja për gjyqtar. Ky tregues nxjerr në pah ngarkesën e lartë në punë për gjyqtar në Gjykatën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE

Numri i gjyqtarëve në gjykatë	Totali i çështjeve të reja të	Totali i çështjeve të gjykuara për	Totali i çështjeve për	Totali i çështjeve të
-------------------------------	-------------------------------	------------------------------------	------------------------	-----------------------

¹ gjyqtarët e larguar dhe gjyqtarët e emeruar në datë 18.10.2023

**ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023**

	paraqitura për gjyqtar	gjyqtar	gjyqtar	mbartura për gjyqtar
1	2	3	4	5
11.1	660	596	828	233

Shpërndarja e ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve (me përjashtim të zv/Kryetarit të Gjykatës) në vitin 2023 është pothuajse e barabartë në numër çështjesh (duke mos patur parasysh kompleksitetin e çështjeve).

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar në total **7328** çështje të reja dhe kanë përfunduar **6614** çështje.

Raporti mbi numrin i çështjeve për çdo gjyqtar (Case for Judge), llogaritur duke pjesëtur numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2022 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës;

$$\frac{7328 \text{ [totali i numrit të çështjeve të regjistruara]}}{11.1 \text{ [numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2023]}} = 660 \text{ Numri i çështjeve për gjyqtar}$$

Ndërsa numri i çështjeve të gjykuara për çdo gjyqtar rezulton si më poshtë:

$$\frac{6614 \text{ [totali i numrit të çështjeve të gjykuara]}}{11.1 \text{ [numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2023]}} = 596 \text{ Numri i çështjeve për gjyqtar}$$

Ngarkesa e lartë e gjyqtarëve ka ndikuar në afatin e arsytimit të vendimeve gjyqësore, por gjithsesi nuk është tejkaluar afati 30 ditor i përcaktuar sipas raportimit pranë KLGJ-së, si dhe përgjithësisht janë respektuar afatet ligjore të arsytimit të vendimeve.

5. SHPEJTËSIA NË GJYKIM SIPAS KATEGORISË SË ÇËSHTJEVE.

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023




Tabela.16


Kategoria e Çështjeve	ÇËSHTJE TË PËRFUNDUARA GJATË VITIT 2023			
	1-6 Muaj	7-12 Muaj	1-2 Vjet	> 2 Vjet
Civile të përgjithshme	247	240	58	38
Familjare	885	241	24	1
Kërkesa pa kundërshtarë	933	42	6	0
TOTALI CIVILE	2065	523	88	39
Penale themeli (krime)	638	27	7	5
Penale themeli (kundervajtje)	124	8		2
Kërkesa administrative penale	2312	776		0
TOTALI PENALE	3074	811	7	7
TOTALI I ÇËSHTJEVE	5139	1334	95	46

Raporti i shpejtësisë së gjykimit të çështjeve në total, penale dhe civile:

Nga totali i 6614 çështjeve të gjykuara, rezulton se 5139 çështje janë përfunduar së gjykuari brenda afatit 6 muaj, 1334 çështje janë përfunduar së gjykuari në harkun kohor 7 - 12 muaj, 95 çështje janë përfunduar së gjykuari në harkun kohor 1 - 2 vjet dhe 46 çështje janë përfunduar së gjykuari në afatin mbi 2 vjet.

Më poshtë po paraqesim edhe raportet e shpejtësisë të gjyimit për çështjet:

Raporti i shpejtësisë së gjyimit të çështjeve civile:



Raporti i shpejtësisë së gjyimit të çështjeve penale:



Analizë mbi përmbushjen e standartave kohore ndërkombëtare

Gjykata ka përcaktuar si objektiv të brendshëm, arritjen e respektimit të afateve të

gjkimit të çështjeve sipas kategorisë më cilësore “A” të CEPEJ (Time Frames “A”). Nga statistikat e mësipërme rezulton se janë përmbushur plotësisht afatet e gjykimit të çështjeve sipas kategorisë më cilësore “A” të CEPEJ (Time Frames “A”).

Konkretisht 78.8 % e çështjeve penale nuk kanë zgjatur më shumë se 6 muaj; 20.8 % e çështjeve (krahasuar me standartin 90-95%) nuk kanë zgjatur më shumë se 12 muaj, dhe vetëm rreth 0.4 % e çështjeve kanë zgjatur më shumë se 12 muaj. Nëse konsiderojmë vetëm çështjet penale themeli, vetëm 1.7 % e tyre kanë zgjatur më shumë se 12 muaj, ndërsa 98.3 % (krahasuar me standartin 90-95%) janë zgjidhur brenda 12 muajve. Gjithashtu përsa i përket çështjeve penale në gjykim (të papërfunduara), vetëm 10.8 % e tyre e kanë kaluar afatin 1 vit. Në këtë aspekt, është evidentuar si shkak për kohëzgjatjen e gjykimit mbi një vit, kryesisht pezullimi i gjykimit për të pandehurit në mungesë për kryerjen e kërkimeve të tjera me afat një vit dhe njoftimi i viktimës, apo njoftimi i të pandehurit me letërporosi.

Çështjet penale për krime, **94.2%** (krahasuar me standartin 98%) janë zgjidhur brenda 6 muajve dhe **4 %** (krahasuar me standartin 100%) brenda 1 viti dhe mund të konsiderohet një parametër i pranueshëm.

Nga të dhënat statistikore rezulton se vetëm për 5 çështje penale është tejkaluar afati 2 vjet i gjykimit.

Nga të dhënat statistikore për çështjet civile rezulton se vetëm 4.7 % e çështjeve të gjykuara e ka kaluar afatin 12 muaj, ndërsa 95.3 % (krahasuar me standartin 90-95%) e çështjeve civile janë gjykuar brenda 12 muajve.

Nga krahasimi i disa prej të dhënave statistikore për vitin 2023 me standartet ndërkombëtare “Standardet Kohore të Dhomës Amerikane të Avokatisë” rezulton se: 93 % e çështjeve civile të përgjithshme (krahasuar me standartin 90%) janë gjykuar brenda 12 muajve, dhe 7 % e çështjeve civile të përgjithshme kanë kaluar afatin 12 muaj. Megjithatë këto rezultate janë të ndikuara edhe nga përballimi i numrit të çështjeve me një numër të kufizuar gjyqtarësh aktualë, ka vend për përmirësimin e këtyre parametrave në vitin që jemi dhe të analizojmë shkaqet e tjera që kanë çuar në këto parametra të ulët.

Përsa i përket çështjeve familjare, vetëm **76.9 %** e tyre (krahasuar me standartin **98%**) janë zgjidhur brenda 6 muajve dhe **97.8 %** (krahasuar me standartin **100%**) brenda 1 viti, që gjithsesi, mund të konsiderohet pozitiv në kushtet që ndodhet gjykata sot.

Gjykata ka përcaktuar si objektiv të brendshëm të saj, dhënien e përparësisë në gjykim të çështjeve tejet komplekse, që kanë zgjatur më shumë se 18 muaj, me qëllim moskalimin e afatit 2 vjeçar të gjykimit, në respektim të jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut.

Nga analiza e të dhënave për çështjet civile të zgjatura mbi 2 vjet rezulton se numri është i vogël, vetëm **39** të tilla (apo **3.4 %** të tyre). Shkaqet e tejkalimit të afatit 2-vjeçar janë kryesisht shkaqe ligjore që përjashtojnë përgjegjësinë për tejkalimin e afatit si:

- njoftimi i njërës prej palëve për gjykimin me letërporosi dhe kohëzgjatja për ekzekutimin e letërporosisë;
- pezullimi i gjykimit, deri në zgjidhjen e një çështje tjetër gjyqësore, apo rastet e tjera të pezullimit të parashikuara në ligj;
- në gjykimet e pjestimit të pasurisë së paluajtshme mosvazhdimi i gjykimit në fazën e dytë të pjestimit deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës për fazën e parë të pjestimit;
- shkaqe objektive për zëvendësimin e gjyqtarëve të çështjes, si heqje dorë, etj., dhe për rrjedhim rifillimi i gjykimit.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) është treguesi që krahason numrin total të çështjeve të pazgjidhura, në fund të periudhës së caktuar, me numrin e çështjeve të zgjidhura, brenda të njëjtës periudhë kohore, raport ky i konvertuar në numër ditësh. Treguesi mat se sa shpejt sistemi gjyqësor i gjykatës punon mbi çështjet e marra që nënkupton kohën që duhet për përfundimin e një lloji çështjesh të caktuara në gjykatë, në dritën e ritmit të punës në atë gjykatë.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës **civile** është **273 ditë**.

$$DT_{\text{Civile 2023}} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2023}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2023}} \times 365 = \frac{2031}{2715} \times 365 = 273$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës **penale** është **52 ditë**.

$$DT_{\text{Penale 2023}} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2023}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2023}} \times 365 = \frac{551}{3899} \times 365 = 52$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për të gjitha çështjet në total është **142 ditë**.

$$DT_{2022} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2023}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2023}} \times 365 = \frac{2582}{6614} \times 365 = 142$$

Për të krahasuar të dhënat dhe për të kuptuar më mirë ecurinë, po bëjmë tabelën dhe grafikun e tendencës për 4 vitet:

Tabela.17

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin çështjeve penale				
Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

44.8	66.1	47.7	53	52
-------------	-------------	-------------	-----------	-----------





Tabela.18

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin çështjeve civile				
Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
66.4	125.5	75.4	113	273




Të dhënat e mësipërme, tregojnë mesatarizimin e kohëzgjatjes në ditë të gjykimeve për kategoritë e çështjeve penale dhe civile. Nga krahasimi me vitet paraardhëse, në të cilin koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve **penale** ishte përkatësisht **51.9 ditë**, **44.8 ditë**, **66.1 ditë**, dhe **47.7 ditë**, rezultojnë një rritje për kohëzgjatjen mesatare të gjyqimit, duke qënë se në 2023 është rreth 52 ditë afersisht

si vitet e mëparshme. Ndërsa për çështjet e natyrës **civile themeli** vërehet rritje krahasuar me kohëzgjatjen mesatare të viteve paraardhëse (2019, 2020, 2021 dhe 2022), pasi gjatë vitit 2023, i gjithë sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë u përball realizimin e hartës së re gjyqësore.

Tabela.19

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin çështjeve në total				
Vitit 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
54.9	92.4	61.6	84	142



Ndërsa për totalin e çështjeve, në krahasim me vitet paraardhëse, rezulton se koha e nevojshme për likuidimin e të gjitha çështjeve, gjatë vitit 2023, është rritur 69 %. Përsërisim si më sipër, tek çështjet civile krahasuar me kohëzgjatjen mesatare të viteve paraardhëse (2019, 2020, 2021 dhe 2022), pasi viti 2023 nuk mund të konsiderohet për ecurinë e veprimtarisë gjyqësore si një vit normal.

6. HEQJET DORË NGA GJYKIMI I ÇËSHTJEVE:


Kërkesat për heqje dorë:

Tabela.20

**ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023**

Emër, Mbiemër	Totali	Penale		Civile	
		Pranuar	Mospranim	Pranuar	Mospranim
1	2	3	4	5	6
Alfred Konomi		7	0	0	0
Ejona Lazellari		1	0	0	3
Erlanda Agaj		1	0	1	0
Ersida Bajgora		7	0	7	3
Esmeralda Ceka		0	0	0	0
Dajana Ndreja		3	1	9	3
Gladiola Bregu		3	1	10	1
Arjeta Lika		0	0	0	0
Nertil Dushku		1	0	6	1
Miranda Nakaj		3	1	1	0
Olkeda Lice		0	0	0	0
Rudi Laze		3	0	7	3
Sonila Hoxha		8	0	0	0
Taulant Banushi		0	0	1	0
Dorina Alushi		0	0	0	0
Juliana Pjetri		0	0	0	1
Genci Busho		0	0	0	0
Klodiana Kryeziu		0	0	0	0
Noel Veizi		0	0	0	0
Vladimir Cjapi		0	1	0	0
TOTALI	98	41		57	

Kërkesat për heqje dorë:



Shkaqet kryesore të heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve edhe në vitin 2023, lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura, apo vendimmarrje të mëparshme ku janë shprehur me vlerësime nga të cilat çënohet paanësia, kjo edhe për shkak të parashikimit në ligj të mosshqyrtimit të një çështje nga gjyqtari që më parë ka gjykuar një çështje tjetër të caktuar. Pjesa tjetër e rasteve të heqjes dorë nga gjykimi lidhet me vlerësimin e ekzistencës së arsyeve të tjera serioze të njëanshmërisë.

7. PËRJASHTIMET E GJYQTARËVE NGA GJYKIMI I ÇËSHTJEVE. (Me kërkesë të palëve)

Gjatë vitit 2023 nuk është pranuar asnjë kërkesë për përjashtim gjyqtari nga gjykimi i çështjeve. Nga analiza e rasteve të shqyrtimit të kërkesave për përjashtimin e gjyqtarëve, vërehet se, shkak kryesor i mospranimit të kërkesës për përjashtim është garantimi i paanshmërisë së gjyqtarit. Shkak i pushimit të kërkesave për përjashtim gjyqtari është shqyrtimi dhe pranimi i kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi. Ndërsa shkaqet kryesore të rrëzimit të kërkesës për përjashtim janë: paraqitja nga pala kërkuese si shkak përjashtimi vendimmarrja e ndërmjetme e gjyqtarit,

**ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023**

mosparaqitja e arsyeve të njëanshmërisë nga ato të parashikuara në ligj, si dhe mosdepozitimi i akteve për të provuar ekzistencën e arsyeve të njëanshmërisë. Krahasuar me të dhënat e viteve të mëparshme rezulton se ka një ulje të numrit të kërkesave për përjashtim gjyqtari në çështjet penale dhe në çështjet civile.

Tabela.21

Emër, Mbiemër	Totali	Penale			Civile		
		Pranuar	Rrëzuar	Deklaruar e papranueshme	Pranuar	Rrëzuar	Deklaruar e papranueshme
1	2	3	4	5	6	7	8
Alfred Konomi	3		1	1		1	
Ejona Lazellari	0						
Erlanda Agaj	0						
Ersida Bajgora	2		1	1			
Esmeralda Ceka	0						
Dajana Ndreja	0						
Gladiola Bregu	1					1	
Arjeta Lika	0						
Nertil Dushku	1						1
Miranda Nakaj	1						1
Olkeda Lice	2		1	1			
Rudi Laze	3			1		1	1
Sonila Hoxha	0						
Taulant Banushi	0						
Dorina Alushi	0						
Juliana Pjetri	0						

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

Genci Busho	0					
Klodiana Kryeziu	0					
Noel Veizi	0					
Vladimir Cjapi	0					
TOTALI	13	7			6	

III. MENAXHIMI I LËVIZJES TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

1. Mbikqyrja e progresit të çështjeve.

➤ Në vazhdimësi gjatë vitit 2023 ka patur bashkëpunim dhe mbështetje nga drejtuesi i Prokurorisë, Dhoma Vendore e Avokatisë, për implementimin e masave që lidheshin me reduktimin e kërkesave për shtyrje, konkretizimin dhe bazueshmërinë e tyre në prova, si dhe një planifikim më të mirë të gjykimit, kryerja e veprimeve procedurale brenda një afati të caktuar etj.

➤ Edhe me institucionet vendore si Komisariati i Policisë Fier, Mallakastër, Lushnje, IEVP Fier, Zyra Postare Fier, Bashkia Fier etj., ka vazhduar bashkëpunimi për masat e ndërmarra në kuadër të planit të veprimit siç janë: paraqitja e dokumentave të kërkuara përpara seancës, komunikimi i shpejtë me gjykatën edhe në rrugë elektronike, përmirësimi i mënyrës së kryerjes së njoftimeve, aplikimi i mënyrave alternative të njoftimit dhe komunikimit si p.sh me rrugë elektronike.

➤ Gjykata ka aplikuar komunikimin elektronik me e-mail edhe me avokatët, apo palë si dhe pjesëmarrës në proces si ekspertët, psikologët etj., si dhe ka përmirësuar përmbajtjen e njoftimeve me qëllim njoftimin në të njëjtën kohë të palëve edhe me të drejtat dhe detyrimet e tyre, si për t'u mbrojtur me avokat para se të fillojë procesi gjyqësor, për të paraqitur prova, etj. Po ashtu është kërkuar bashkëpunimi i të gjitha institucioneve vendore për komunikimin në rrugë zyrtare elektronike në një afat sa më të shpejtë nëpërmjet adresës elektronike zyrtare dhe bashkëpunimi me njësitë vendore dhe Bashkitë lidhur me përmirësimin dhe konfirmimin në kohë të njoftimit me shpallje.

➤ Nga ana e gjykatës janë organizuar një sërë takimesh si me përfaqësues të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Dhomës Vendore të Avokatisë Fier, IEVP-në në juridiksionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, etj. Gjithashtu janë zhvilluar takime me punonjës të Zyrës Postare Fier, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit postar

gjqësor dhe zgjidhjes së problematikave të shtyrjes së seancave për arsye të moskthimit në kohë të përgjigjeve, apo parregullsive në njoftime.

2. Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS).

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier që prej vitit 2010 aplikohet sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ICMIS. Pavarësisht problematikave të evidentuara në mënyrë të vazhdueshme për funksionimin e këtij sistemi dhe disa zgjidhjeve të ofruara në vijimësi, ende mbeten për zgjidhje disa problematika, ku ndër më kryesoret renditen:

- Mospërshtatja me ndryshimet ligjore në K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale përsa i përket gjykimeve në dhomë këshillimi, regjistrimit të kërkesave të seancës paraprake dhe gjykimeve të reja të posacme si Urdhëri Penal dhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë etj.

Në sistemin elektronik ka funksionuar programi PAKS+ me qëllim planifikimin dhe raportimin e seancave gjyqësore sipas sallave të lira. Kushtet në gjykatë për shkak të mungesës së sallave, nuk lejojnë një punë normale në planifikimin e sallave të gjyqit, duke ulur efikasitetin e punës dhe të kohës.

3. Sistemi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore.

Në sajë të sistemit të regjistrimit audio të seancave (RDA), seancat gjyqësore janë zhvilluar në çdo rast në 5 sallat e gjyqit që ka gjykata dhe janë regjistruar audio. Regjistrimi audio i seancave gjyqësore për vitin 2023 është **85.4%** e seancave të zhvilluara, ç'ka pasqyron qëndrueshmerinë e përdorimit të teknologjisë audio nga ana e gjykatës.

Përjashtim nga ky rregull përbejnë rastet e seancave për shqyrtimin e kërkesave penale me karakter sekret, apo shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi, në të cilat nga gjykata nuk aplikohet përdorimi i sistemit RDA.

Ndërsa numri i seancave totale për të gjitha çështjet për vitin 2023 është 19101 (sipas të dhënave të sistemit PAKS+).


Tabela.22

**Raport për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio për periudhën
01.01.20223-31.12.2023**

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

Përqindja e seancave të zhvilluara me mjete audio	85.4%
Përqindja e seancave të zhvilluara pa audio	14.6%

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Totali i seancave audio në periudhën 01/01/2023 - 31/12/2023



Numri i seancave të zhvilluara dhe regjistruara sipas të dhënave të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve ICMIS për vitin 2023, për shqyrtimin e çështjeve në total është 19101 krahasuar me 21767 seanca në vitin 2022, dhe 25435 në vitin 2020. Ulja e numrit të seancave krahasuar me vitin 2022, lidhet përveç se me ndryshimet në K.Pr.Penale dhe K.Pr.Civile për shtimin e çështjeve që shqyrtohen në dhomë këshillimi (si p.sh. kërkesat për përjashtim gjyqtari, kërkesat për caktim mase sigurimi personal, kërkesat për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, etj.) edhe marrjen e masave nga gjykata për reduktimin e seancave joproduktive në kuadër të Nismës “Drejtësi pa vonesa”.

Raport për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio nga çdo gjyqtar në periudhën 01/01/2023 - 31/12/2023

Gjyqtar	Nr. i seancave audio	Nr. i seancave në sallë	Nr. i seancave në zyrë	Totali i seancave të mbajtura	% seanca të regjistruara
Alfred Konomi	2752	2732	528	3260	84.40%

**ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023**

Arjeta Lika	38	35	4	39	97.40%
Dajana Ndreja	1192	1188	308	1496	79.70%
Dorina Alushi	130	135	27	162	80.20%
Ejona Lazellari	77	77	43	120	64.20%
Erlanda Agaj	356	355	27	382	93.20%
Ersida Bajgora	2153	2149	255	2404	89.60%
Esmeralda Çeka	264	253	11	264	100.00%
Genci Busho	225	239	28	267	84.30%
Gladiola Bregu	1042	1039	363	1402	74.30%
Juliana Pjetri	162	169	25	194	83.50%
Klodiana Kryeziu	183	189	17	206	88.80%
Miranda Nakaj	2269	2201	213	2414	94.00%
Nertil Dushku	1217	1240	276	1516	80.30%
Noel Veizi	220	225	20	245	89.80%
Olkeda Lice	1716	1763	207	1970	87.10%
Rudi Laze	1036	1071	261	1332	77.80%
Sonila Hoxha	778	788	107	895	86.90%
Taulant Banushi	240	239	19	258	93.00%
Vladimir Cjapi	255	254	21	275	92.70%
Totali	16305	16341	2760	19101	85.40%

Një pengesë të konsiderueshme në shpejtësinë e gjykimit edhe në vitin 2023, përbën sistemi i shërbimit postar të njoftimeve, mungesa e një sistemi të saktë adresash, mungesa e njohurive procedurale të punonjësve të postës që kryejnë njoftimet për llogari të Gjykatës. Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë: mosparaqitja e palëve në gjykim, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër, arsye shendetesore, etj. Në disa raste palët ndërgjygjëse hasin vështirësi për të siguruar dhe paraqitur provat e caktuara të cilat ndodhen pranë institucioneve shtetërore, dhe në disa raste vetë këto institucione përmbushin me vonesë urdhërat e gjykatës. Ndër faktorët e tjerë të brendshëm që ndikojnë në shpejtësinë e gjykimit mbeten sikurse në vitin e kaluar ngarkesa shumë e lartë në punë për secilin gjyqtar, referuar numrit mesatar të çështjeve për gjyqtar dhe organikës së gjykatës. Këto problematika, kanë sjellë si domosdoshmëri një rol më aktiv të gjyqtarit për administrimin e procesit gjyqësor. Shkaqet e shtyrjes së seancave dhe zhvillimit të seancave joproduktive janë diskutuar rregullisht në të gjitha mbledhjet periodike me gjyqtarët me qëllim dhe duke sjellë në vijim marrjen e masave për reduktimin e tyre.

Në vitin 2023, të gjithë palët pjesëmarrëse në një seancë gjyqësore, janë pajisur me CD e regjistrimeve audio, sa herë që kanë bërë kërkesë për të patur një të tillë. Në

faqen web të gjykatës është vendosur edhe suporti i duhur për përdoruesit e programit FTR, për të dëgjuar regjistrimet audio.

Zbatimi i këtij sistemi ka rritur ndjeshëm transparencën e gjykimit dhe ka ndikuar ndjeshëm në respektimin e rregullave të etikës dhe solemnitetit në gjykim.

Përdoruesit, apo punonjësit janë udhëzuar për përdorimin e sistemit audio dhe kanë realizuar me sukses edhe transkriptimet e procesverbaleve të seancave edhe në rastet kur ai është kërkuar fjalë për fjalë, si dhe është zbatuar udhëzimi për proceduarat e dhënies së kopjeve të regjistrimeve audio për përdorim nga publiku. Zbatimi i këtij sistemi ka treguar se ka rritur ndjeshëm transparencën e gjykimit dhe ka ndikuar ndjeshëm në respektimin e rregullave të etikës dhe solemnitetit në gjykim si për gjyqtarët, ashtu edhe për palët në gjykim dhe përfaqësuesit e tyre.

IV. MENAXHIMI ADMINISTRATIV I GJYKATËS:

1. Organika dhe burimet njerëzore.

Organika e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për periudhën Janar – Prill të viti 2023 përbëhet si më poshtë:

- ✓ Gjyqtarë të punësuar dhe të regjistruar në listpagesën e Sigurimeve janë 14 ku 1 prej tyre kryen dhe funksionin e kryetarit, 3 janë të pezulluar nga KPK, 2 jane komanduar në KLGJ, 1 gjyqtar komanduar ne Gjykatën e Lartë, 1 gjyqtar i komanduar ne ILD dhe 3 gjyqtare transferuar perkohesisht ne Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane. Ndërkohë në bazë të organikës janë të planifikuar 21 gjyqtarë.

Në datën 01.Maj 2023 u krye riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë duke bashkuar dy gjykatat e Rrethit Fier dhe të Rrethit Lushnje në një të vetme. Ky riorganizim bëri që organika të ndryshonte të rritej për të përballuar fluksin e punës. Të ndodhur para faktit, u planifikua që numri i gjyqtarëve të jetë 21 dhe numri i nëpunësve civil gjyqësor 49 punonjës.

Në muajin Tetor 2023, organikës së gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier i shtohen dhe 6 gjyqtarë të rinj duke çuar numrin e gjyqtarëve gjithsej në 14 efektive. Gjate vitit 2023, Keshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier i është drejtuar KLGJ-se për shtesë në organike konkretisht për sekretare gjyqësore për të bazuar numrin e gjyqtarëve me numrin e sekretarëve gjyqësore, 1 sekretare gjyqësore në K/Sekretari, për një specialist statistikash si edhe punonjës të arkives.

2. Teknologjia e informacionit.

Të gjithë gjyqtarët dhe administrata kanë në dispozicion pajisje të teknologjisë së informacionit që plotësojnë nevojat e punës së tyre në gjykatë. Në mënyrë periodike është bërë rifreskimi i këtyre pajisjeve. Të gjithë zyrat e gjyqtarëve, janë të pajisur përveç PC dhe printerave, edhe me skaner. Pajisja me këtë pajisje ndihmon në punën e përditshme të gjyqtarëve, pasi kursen kohë dhe bën më të lehtë dërgimin elektronik të dokumentave zyrtarë në institucione të tjera, sidomos në IEVP-të, që janë në juridiksionin e Gjykatës sonë.

Shorti elektronik: - Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ICMIS mundëson përveç të tjerash ndarjen e çështjeve ndërmjet gjyqtarëve, me short elektronik. Kërkesat e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për procedurat e ndarjes së çështjeve me short” dhe Vendimit të KLGJ-së janë respektuar në mënyrë rigorozë në lidhje me ndarjen e çështjeve me short si dhe është rritur transparenca e këtij procesi, duke u publikuar paraprakisht koha e realizimit të shortit, duke u garantuar pjesëmarrja e publikut, si dhe nëpërmjet publikimit të listës së shortit. Nëpërmjet përcaktimit të vendit të zhvillimit të shortit dhe rishortimit, në hollin e Gjykatës, të pajisur me monitor, është rritur aksesin nga pjesëmarrës të tjerë të interesuar si palët, avokatët mbrojtës, media. Shorti i ditës, publikohet menjëherë në këndin e njoftimeve të gjykatës, Website e Gjykatës si edhe Facebook te Gjykatës.

Nga të dhënat statistikore rezulton se çështjet janë shpërndarë në mënyrë përafërsisht të barabartë për të gjithë gjyqtarët. Diferencat justifikohen duke patur parasysh numrin e çështjeve të regjistruara gjatë gadishmërisë së secilit gjyqtar, që mund të ketë qenë jo i barabartë.

Për masat e sigurimit dhe kërkesat gjatë hetimeve paraprake, nga Zv.Kryetari e Gjykatës në zbatim të kompetencave ligjore është bërë sistematikisht planifikimi i gadishmërisë të gjyqtarëve sipas grafikut për shqyrtimin e çështjeve të natyrës urgjente, si edhe gadishmerine e shqyrtimit të çështjeve penale për të miturit si rregull për një kohë një javore sipas rendit alfabetik duke marrë për bazë mbiemrin e gjyqtarit.

3. Programi i transparencës

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur, programi i transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Programi i Transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është i publikuar dhe i përditësuar në faqen zyrtare të portalit të gjykatave. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve të rrjedhura nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji, për publikim kryesisht nga autoriteti publik.

4. Ofrimi i shërbimeve nga administrata gjyqësore.

Kryesekretaria dhe sekretaria gjyqësore janë funksionet që kanë qenë më shumë të ngarkuar. Vlen të theksohet ngarkesa shumë e lartë me çështje për secilin gjyqtar (mesatarisht **660** çështje të shqyrtuara për secilin) e numri total i seancave në vit dhe për rrjedhim ngarkesa e lartë në punë e secilës sekretare gjyqësore.

Rëndësi të veçantë i është kushtuar ofrimit të një shërbimi sa më të shpejtë dhe korrekt ndaj publikut, ndaj do të duhet që për vitin në vazhdim të ketë më tepër trajnime në drejtim të performancës, etikës së komunikimit, organizimit të punës dhe shërbimit ndaj qytetarëve.

Gjatë vitit 2023 ka patur një numër të konsiderueshëm kërkesash për shërbim nga arkiva. Problematikë vijon të mbetet mungesa e hapësirave të nevojshme për sistemimin dhe inventarizimin e dosjeve arkivore në ambientet e arkivës. Në pamundësi absolute të hapësirave të nevojshme, arkiva penale dhe civile është e shpërndarë në disa ambiente të ndryshme të gjykatës, përfshirë edhe zyra gjyqtarësh (të larguar), të cilat funksionojnë si arkivë.

Në Gjykatën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka perfunduar përpunimi i dokumentacionit arkivor për vitet 2007-2010, dhe është kryer transferimi i tyre për në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor Tirane, në përmbushje të kërkesave të vendimit Nr. 903, datë 17.12.2014 "*Per krijimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor*", të urdhërave të Ministrit të Drejtësisë nr. 4895/4 dhe nr. 48955 datë 01.11.2016 "*Për miratimin e formateve tip të dokumenteve gjyqësore që arkivohen nga gjykatat*" dhe "*Për miratimin e rregullores mbi metodikën dhe tipologjinë e menaxhimit të arkivës gjyqësore*". Ky proces është ndërprerë për arsye se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në cilësinë e Organit Qëndror Blerës, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me marrëveshje kuadër për blerjen e kutive e dosjeve me ruajtje të përherëshme për vitin 2022, sipas VKM-së nr. 360, datë 26.04.2017, "*Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave*", i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.3, datë 8.2.2021, të Këshillit të Lartë të Arkivave "*Për miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve, për ruajtje të përherëshme, si dhe listës së institucioneve dhe tipologjisë e dokumenteve të institucioneve që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde*".

5. Aksesit, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median.

Në vitin 2023 janë përdorur Letrat e të Drejtave dhe Broshurat Informuese, që përcaktojnë të drejtat dhe detyrat e palëve ndërgjyqëse, viktimave për zhvillimin e procesit gjyqësor. Sekretaria gjyqësore bashkëngjitur fletëthirrjes apo dëftesës së komunikimit, i dërgon të pandehurit, viktimës, si dhe të paditurit në procesin civil

“Letrën e të drejtave dhe detyrave në proces“. Këto akte janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të gjykatës dhe në standën e njoftimeve të gjykatës. Me qëllim rritjen e aksesit në drejtësi, është rritur numri i formularëve standart për kërkesa të ndryshme drejtuar gjykatës, siç janë: model deklaratë mbrojtje, model kërkesë për informacion, model format ankese, formulari për të përfituar ndihmën juridike falas, si dhe akte të tjera të cilat ndihmojnë në veçanti palët e vetëpërfaqësuar.

Kanalet e komunikimit dhe mekanizmat që përdoren më shumë nga gjykata për informimin e medias dhe qytetarëve janë nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Gjykatës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier www.gjykata.gov.al/gjykata.fier@gjykata.gov.al, e cila administrohet nga specialistja e IT-së së gjykatës, nëpërmjet postës elektronike të nëpunësit të marrëdhënieve me median dhe publikun dhe të specialistes së IT-së, nëpërmjet numrit të telefonit, WhatsApp-it, rrjetit social Facebook, si dhe nëpërmjet shërbimit postar. Gjithashtu, në dispozicion të medias dhe qytetarëve është vënë kutia e ankesave në një vend të dukshëm dhe të aksesueshëm në hyrje të gjykatës. Janë ndjekur format më bashkëkohore të komunikimit të cilat përfshijnë ndërveprimin e drejtëpërdrejtë të gjykatës me median dhe qytetarët.

Gjithashtu, është arritur asistencë e personave me aftësi të kufizuar nga një punonjës i gjykatës, është siguruar përcaktimi i një ambienti të posaçëm për qëndrimin në hyrje të gjykatës dhe publikimi i të drejtave dhe garancive. Gjykata ka arritur të sigurojë gjithashtu akses fizik nëpërmjet rampave në hyrje të gjykatës për personat me aftësi të kufizuar në lëvizje. Por, gjykata për shkak të papërshtatshmërisë së godinës, e ka ende të pamundur të sigurojë akses fizik nëpërmjet rampave të personave me aftësi të kufizuar në lëvizje në sallat e gjykimit. Edhe në vitin 2023 ky akses fizik garantohet vetëm për sallën e hyrjes në gjykatë në kryesekretari. Gjykata ende nuk mundëson pajisje apo mjete të duhura për lehtësimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuara, të cilët ndihmohen nga të afërmit e tyre, apo punonjësit e gjykatës. Sfidë për të ardhmen mbetet sigurimi i aksesit fizik të personave me aftësi të kufizuara në lëvizje, në sallat e gjykimit; sigurimi i asistencës së specializuar si interprete etj., nga organizata joqeveritare për personat me aftësi të kufizuar që marrin pjesë në procese, apo marrin shërbim në gjykatë.

Edhe gjatë vitit 2023 në drejtim të rritjes së transparencës dhe aksesit në drejtësi, ka vijuar aksesit nëpërmjet pajisjes “infopoint” të vendosur në hollin e gjykatës. Nëpërmjet pajisjes “Infopoint” dhe video informuese, publiku, avokatët, përfaqësuesit, palët apo të gjithë personat e interesuar kanë patur mundësi të marrin informacione në kohë reale mbi orarin e gjykimeve, shortin dhe informacione të tjera nga faqja zyrtare e internetit të gjykatës ose nga sistemi i gjykatës në çdo kohë, pa patur nevojë të pyesin ose të presin në sekretarinë e gjykatës, qoftë edhe jashtë orarit të shërbimit.

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përditësuar programi i transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në faqen zyrtare <http://www.gjykata.gov.al>. Gjykata ka

publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji për publikim kryesisht nga autoriteti publik. Mbështetur në nenin 4 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka nxjerrë Urdhërin Nr.14, datë 22.01.2015 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës”, ndryshuar me Urdhërin Nr.187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës të Rishikuar” dhe Urdhërin Nr.188, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar”, të cilat janë implementuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier si në formë, ashtu edhe përmbajtje, sipas kategorive të përcaktuara. Ky detyrim ligjor zbatohet nga specialisti i marrëdhënieve me publikun dhe median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në bashkëpunim me specialistin e IT-së së Gjykatës, nën mbikqyrjen e Gjyqtarit të Medias dhe Këshillit të Gjykatës.

Gjithashtu, përgjatë vitit 2023 është publikuar i përditësuar në faqen zyrtare të gjykatës, si dhe në këndin e njoftimeve të publikut “*Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve*”, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në zbatim të Urdhërit Nr.188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Më konkretisht, gjatë vitit 2023 janë trajtuar gjithsej 99 kërkesa për informacion/dokumentacion, krahasur me 77 kërkesa për vitin 2022 dhe 78 kërkesa për vitin 2021. Shihet qartë një tendencë dukshëm në rritje të kërkesave për informacion/dokumentacion. Në pjesën më të madhe të tyre, këto kërkesa për informacion paraqiten nëpërmjet postës elektronike e-mail. Përgjigjet janë dhënë të plota në 96 kërkesa për informacion, vetëm 1 kërkesë është deleguar në një autoritet tjetër dhe vetëm në 2 raste kërkesa për informacion është dhënë e kufizuar në bazë të Nenit 17 pika 1 gërma "a" dhe Neni 17 pika 4 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, të ndryshuar. Pavarësisht afatit ligjor, përgjigjet janë dhënë në afatet më të shkurtra të mundshme, me tarifë zero, pasi informacioni është dhënë po me e-mail dhe dokumentacioni është dhënë i skanuar. Do të sugjeroja të kishte një unifikim praktike për sistemin gjyqësor në lidhje me rastet specifike

Aktualisht portali gjykata.gov.al aktualisht ofron një mënyrë automatike për anonimizimin e të dhënave personale, por kjo mënyrë nuk është 100% efikase për mbrojtjen e të dhënave personale, kjo pasi përmbajtja e arsyetimit të vendimit nuk realizohet plotësisht anonimizimi dhe nga verifikimet e kryera disa emra apo mbiemra në raste të ndryshme nuk arrihet të anonimizohen automatikisht nga portali në fushën e arsyetimit të vendimit. Rregullimi i kësaj problematike është shumë e rëndësishme për shkak edhe të qëndrimit të mbajtur nga ana e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu përveç ndryshimeve në lidhje me anonimizimin në portal, evidentojmë edhe faktin se publiku, palët, avokatët nuk arrijnë të bëjnë kërkim duke përdorur emrin apo mbiemrin e palës. Ky ndryshim funksionaliteti në portal nuk

është mirëpritur nga publiku, pasi paraqet vështirësi për kërkimin e informacionit të çështjes në faqë elektronike zyrtare të gjykatës, duke qënë se me ndryshime e fundit kërkimi është kufizuar dhe mund të bëhet vetëm duke patur numrin elektronik të anonimizimit të çështjes.

Në raport me median, gjykata ka trajtuar kërkesat për informacione apo ndjekje të seancave gjyqësore për çështje për të cilat media ka patur interes publik. Në këto raste media, apo gazetarët personalisht janë informuar me anë të njoftimeve elektronike si dhe në raste të tjera të veçanta me kërkesë të tyre është mundësuar prezenca në seancat gjyqësore publike duke mbajtur shënime apo dhe pamje filmike. Me qëllim përcjelljen e informacionit të saktë dhe në kohë reale, përsa i përket në veçanti masave të sigurimit ku media ka shfaqur interes, është krijuar një grup në WhatsApp me të gjithë gazetarët që ndjekin fushën e drejtësisë, si një prej formave më të shpejta dhe efikase të komunikimit.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Komunikimit për Gjykatat 2022 – 2024, miratuar me vendimin e KLGJ-së Nr.454, datë 02.11.2022, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të patur një komunikim transparent, me cilësi dhe profesionalizëm, me qëllim për t'i shërbyer publikut dhe grupeve të interesit, si dhe për të rritur në tërësi besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

Gjatë vitit 2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në faqen zyrtare të saj <https://www.gjykata.gov.al/rrethi-fier/gjykata-e-rrethit-fier> dhe në rrjetet sociale, si Facebook, ka publikuar në lidhje me:

- Riorganizimin e kompetencave tokësore të gjykatave;
- Broshurë informuese në lidhje me funksionimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Broshurë informuese në lidhje me selinë, kontaktet dhe kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
- Broshurë informuese në lidhje me Zyrën e Shërbimit Lushnje, kërkesat që mund të paraqiten, funksionet;
- Broshurë informuese në lidhje me “Ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;
- Sistemi i Regjistrimit Dixhital Audio nëpër gjykata dhe arsyet se përse është i nevojshëm.
- Shërbimet që ofrojnë gjykatat për qytetarët;
- Publikimi i shortit në faqen zyrtare të gjykatës gjykata.fier@gjykata.gov.al dhe në Facebook-un e Gjykatës;
- Përrjashtimin nga tarifatat dhe shpenzimet gjyqësore;
- Broshurë informuese/manual mbi përfitimin e ndihmës juridike falas;
- Të dhënat statistikore;
- Kalendari i seancave gjyqësore;
- Mbledhjet e Këshillit të Gjykatës;

- Njoftimi/komunikimi i palëve për proceset gjyqësore, nëpërmjet adresës elektronike të gjykatës gjykata.fier@gjykata.gov.al;
- Përditësimi dhe publikimi i Regjistrit të Kërkesave për Informacion çdo 3-Mujor dhe Vjetor 2023;
- Publikimin e adresave elektronike (e-mail) gjykata.fier@gjykata.gov.al; Sara.Hoxha@gjykata.gov.al dhe Stela.Fili@gjykata.gov.al për të gjithë të interesuarit;
- Vënia e posterave, afishimi në ambientin fizik (tek holli i gjykatës) dhe publikimi i Kodit QR;
- Janë vënë në dispozicion të qytetarëve numrat e telefonit fiks për të rritur mundësinë e kontaktit të shpejtë dhe efikas me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si dhe me Zyrën e Shërbimit Lushnje.
- Publikimi dhe afishimi i orarit të shërbimeve nga e hëna në të premten, gjatë orarit zyrtar 08⁰⁰-16⁰⁰.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr.101, datë 06.03.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit Nr.280, datë 10.12.2019 “Për caktimin e gjyqtarëve për Mediat” për çdo gjykatë, ku është caktuar Z.Alfred Konomi në pozicionin e Gjyqtarit për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Kjo është një ndihmesë e madhe për specialistin për t’u konsultuar me Gjyqtarin e Medias në lidhje me çdo kërkesë për informacion që paraqitet në Gjykatë, si dhe në lidhje me “Njoftimet për Shtyp” për çështjet të cilat kanë interes publik. Së bashku me Gjyqtarin e Medias, Z.Alfred Konomi, gjatë vitit 2023 janë dhënë për Mediat “Njoftime për Shtyp” për çështje që kanë pasur interes të veçantë publik. Gjithashtu, janë realizuar takime të shpeshta me gazetarët që mbulojnë fushën e drejtësisë dhe kemi raportuar të dhëna statistikore për çështjet e përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Interes të veçantë për Mediat kanë patur çështjet që kanë të bëjnë me “Dhunën në familje”.

Gazetarët që mbulojnë fushën e drejtësisë janë mirëpritur në takim edhe nga Zëvendëskryetarja e Gjykatës, ku janë parashtruar problematikat, si dhe mundësitë për përmirësimin e komunikimit mes gjykatës dhe medias në përcimin në mënyrë të qartë, të saktë dhe në kohë reale të lajmit që përbën interes publik. Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka dhënë një njoftim për mediat me anë të të cilit u komunikua se në datën 23.10.2023 trupës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier iu shtuan edhe gjashtë anëtarë të rinj, duke e çuar në 14 gjyqtarë numrin e gjyqtarëve pranë Gjykatës. Ky është një lajm i mirë jo vetëm për Gjykatën, por për të gjithë banorët ku kjo Gjykatë ushtron juridiksionin e saj, pasi do të ndikojë në përfundimin më të shpejtë të çështjeve gjyqësore, do të sjellë shpërndarje të barabartë të drejtësisë, balancim të numrit të gjyqtarëve me çështjet në shqyrtim dhe do të çojë në uljen e numrit të dosjeve të prapambetura.

Me rastin e 10 Majit – “Ditës Kombëtare të Drejtësisë”, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, priti në ambientet e saj nxënësit e shkollës 9-vjeçare: “Andon Xoxa”, të cilët ishin të shoqëruar me mësuesen e lëndës Histori-Gjeografi dhe Qytetari. Në prani të Gjyqtarit të Medias, Specialistes së Marrëdhënieve me Publikun dhe me Median, si dhe nëpunësve civilë të administratës së Gjykatës u zhvillua prezantimi i nxënësve me ambientet e brendshme të gjykatës. Në sallën Nr.3 u zhvillua një seancë me pyetje dhe përgjigje. Nxënësit gjatë këtij takimi u njohën me strukturën, organikën, funksionin dhe veprimtarinë gjyqësore. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i brezit të ri me të drejtat e tyre, si dhe për të nxitur ata nxënës që aspirojnë të ndjekin studimet në fushën e drejtësisë.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të përafrimit të gjykatës me publikun. Kjo eksperiencë rezultoi e dobishme dhe argëtuese për nxënësit, për të kuptuar mendimet dhe zgjidhjet alternative të tyre mbi mënyrën sesi bëhet drejtësi, si dhe për ata nxënës të cilët aspirojnë të studiojnë në fushën e drejtësisë. Në fund të takimit u bënë edhe foto, por u respektua e drejta e nxënësve për mos t’u publikuar këto foto në rrjetet sociale të Gjykatës.

Ndërsa në kuadër të 8-Dhjetorit, Ditës Kombëtare të Rinisë në Shqipëri dhe në zbatim të Planit Strategjik të Komunikimit mes Gjykatave dhe Grupeve të Interesit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, zhvilloi më datë 07.12.2023 aktivitetin me temë: “Ditë e Hapur në Gjykatë” me pjesëmarrjen e nxënësve maturanë të Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Janaq Kilica”, Fier.

Nxënësit u mirëpritën nga Kryetarja në Detyrë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Znj.Olkeda Lice, nga Gjyqtari i Medias, Z.Alfred Konomi, si dhe nga Specialistja e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Median, Znj.Stela Fili.

Takimi u hap me fjalimin hyrës të Kryetares në Detyrë të Gjykatës, Znj.Olkeda Lice për të nxitur nxënësit drejt normave dhe parime të shëndetshme, edukimit ligjor, si dhe për të inspiruar ata nxënës që duan të vijojnë studimet e tyre në fushën e drejtësisë. Më tej diskutimin e orientoi në shpjegimin e mjeteve juridike që atyre e drejta iu njeh për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre si dhe bërë një prezantim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

Pikat kyçe të këtij aktiviteti, ndër të tjera ishin:

- Një prezantim me ambientet e brendshme të Gjykatës dhe me sallat e gjykimit;
- Përmbledhje të Reformës në Drejtësi dhe Harta e Re Gjyqësore;
- Prezantimi i organikës, funksionimi, veprimtaria gjyqësore, veprimtaria administrative, si dhe shërbimet që Gjykata ofron për qytetarët.
- Shërbimet on-line për aksesimin e Gjykatës.
- Promovimi i faqes zyrtare/portalit të Gjykatës, si dhe në rrjetet sociale.

- Roli i Gjyqtarit të Medias dhe Koordinatorës, si urë lidhëse mes Gjykatës dhe përdoruesve të saj, në kuadër të së drejtës së informimit (Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”);
- Një prezantim i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Në fund të këtij takimi u zhvillua seksioni i pyetjeve dhe përgjigjeve.

Synimi i këtij aktiviteti ishte informimi, edukimi, ndërgjegjësimi dhe thellimi i njohurive të brezit të ri në fushën e drejtësisë.

Rekomandime për përmirësimin e objektivave, hapave dhe aktiviteteve konkrete

Do të na ndihmonte shumë ngritja e një platforme unike komunikimi (krijuar nga KLGJ) për të gjithë sistemin gjyqësor në rang vendi, e cila të ofrojë shumëllojshmëri informacioni për të gjitha kategoritë e personave të interesuar dhe që të jetë lehtësisht on-line e aksesueshme. Besimi i publikut është thelbësisht i varur nga shërbimet që gjykata ofron. Sugjeroj që të gjitha gjykatat në rang vendi të ofrojnë të njëjtin informacion në platformat e tyre zyrtare, duke përdorur të njëjtën metodë kërkimi, të shoqëruara me video informuese dhe në veçanti me gjuhën e shenjave për të gjithë përfituesit e këtyre shërbimeve. Aksesit, komunikimi profesional, besueshmëria dhe përgjegjësia mbeten prioritetet e punës sonë me qëllim rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

6. Çështjet e infrastrukturës, ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë.

Në vitin 2023 janë marrë masa për përmirësim në drejtim të sistemit të monitorimit të lëvizjeve në ambientet e brendshme të gjykatës. Gjithashtu janë marrë masa për monitorimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar për mbrojtjen nga zjarri, përmbytjet dhe rreziqe të tjera. Po ashtu janë hartuar rregullat për garantimin e rendit dhe sigurisë në gjykatë.

Godina e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është ndërtuar rreth vitit 1985. Është një godinë katërkatëshe, në të cilën janë vendosur 3 institucione: Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në katin e parë dhe të dytë, Zyra e Përmbarrimit Fier në një pjesë të katit të parë dhe Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në një pjesë të katit të parë dhe të dytë, dhe në katin e tretë dhe të katërt.

Në kushtet infrastrukturore, tërësisht të mangëta të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ushtrojnë aktualisht detyrën 14 gjyqtarë, të cilët i zhvillojnë seancat gjyqësore në 5 salla gjykimi. Në zyrat e vogla të gjyqtarëve rreth 9 metër katrore, asistojnë edhe sekretaret gjyqësore.

Megjithëse në keto kushte, prej Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë marrë masat e duhura për garantimin e sigurisë në gjykatë.

Palët pjesëmarrëse në proces hyjnë nëpërmjet derës kryesore të gjykatës, duke kaluar tek pajisja Metal Dedektor, të ndihmuar nga punonjësi i caktuar me këtë detyrë, me qëllim për t'iu nënshtruar kontrollit fizik. Ne hyrjen kryesore/ballore të gjykatës kryhet shërbimi ndaj publikut.

Në pjesën ku ndodhen zyrat e 14 gjyqtarëve, ndodhen dhe sallat e gjykimit, gjë që e bën të pamundur shmangien e kontaktit të palëve ndërgjyqëse, përdoruesve të gjykatës, me gjyqtarin.

Në ambientet e brendshme dhe të jashtme të gjykatës janë instaluar 22 kamera sigurie. Në vendqëndrimin e punonjësit të sigurisë, është vendosur monitori me të gjitha paisjet përkatëse me akses vëzhgimi të kamerave të sigurisë në të gjitha ambientet e gjykatës.

Godina e gjykatës ka 3 fasada të dukshme (një fasad është bashkë me institucionin e prokurorisë) në kontakt me ambientet e jashtme, dhe një prej tyre është rrugë kryesore për automjete dhe kembesor.

Për rritjen e kushteve të sigurisë dhe zhvillimin normal të aktivitetit të gjykatës në bashkëpunim me KLGJ-në, Ministrinë e Drejtësisë dhe Pushtetin Vendor, duhet kryer ndërtimi, apo sistemimi/vendosja e gjykatës në një godinë tjetër.

Në bashkëpunim me KLGJ-së me Ministrinë e Drejtësisë kërkohet të kryhet zhvendosja e Zyrës së Përmbaramit Shtetëror në një godinë tjetër, duke krijuar mundësinë që sipërfaqes së gjykatës t'i shtohet edhe hapësira e Zyrës së Përmbaramit dhe kjo hapësirë të përshtatet si ambient për të miturit ose Arkivë.

Shërbimi i sigurisë dhe ruajtjes së godinës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për vitin 2023, në bazë të kontratës së shërbimit, nr. 6063, datë 20.11.2023, nënshkruar midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe shoqërisë Illyrian Guard Sh.a. kryhet nga shoqëria "Illyrian Guard" Sh.a.

7. Administrimi i fondeve publike për vitin 2023

Për vitin 2023, është akorduar një fond page dhe sigurime shoqërore në shumën prej 122.000.000 (njëqind e njëzetë e dy milion) lekë i cili është realizuar në masën 98.6 %.

Fondi i shpenzimeve operative është planifikuar në shumën 18.400.000 (tetëmbëdhjetë milion e katërqind mijë) lekë dhe është realizuar në masën 99.8 %.

Përdorimi i këtij fondi është shpërndarë si më poshtë:

- 17 % e fondit është përdorur për mbulimin e shpenzimeve për materiale zyre si letër, tonera, kancelari, shpenzime për transport, mirëmbajtje të pajisjeve elektronike, mirëmbajtje godine, etj, në masën 3.077.477 lekë.
- 29% e këtij fondi është përdorur për mbulimin e shpenzimeve për shërbime të përgjithshme si energji, postë, ujë, telefon fix, celular, etj. Respektivisht në vlerën 5.297.600 lekë.

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER PËR VITIN 2023

- 36% e fondit është përdorur për pagesate vendimeve gjyqësore për difference page te gjyqtarëve për periudhën Janar 2019-Maj 2021 në shumën 6.641.544 lekë.
- 18 % e fondit është përdorur për mbulimin e shpenzimeve si : taksat vjetore, pagesat për avokatë kryesisht, ekspertë, përkthyes, në vlerën 3.353.627 lekë.

Fondi i investimeve për vitin 2023 u akordua në shumën 5.900.000(pesë milion e nëntëqind mijë) lekë, nga të cilat 5.400.000 ishte parashikuar për rimodelimin e dhomës së serverit, projekt i cili nuk u realizua, fond i cili u transferua në KLGJ në muajin Dhjetor, si dhe 500.000 (pesëqind mijë) lekë, i planifikuar për mobilje zyre i cili u realizua në vlerën 330.000(treqind e tridhjetë mijë) lekë, me të cilin u prokuruan mobilje për 4 zyra gjyqtari.

Gjatë vitit 2023 janë krijuar gjithsej të ardhura në shumën prej 1.880.612(një milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) lekë, të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit.

Pasqyrimi i fondeve në total:

Nr	Përshkrimi i shpenzimit	Plani në lekë	Realizuar në lekë	Realizuar në përqindje
1	Shpenzime për personelin, paga dhe sigurime shoqërore	122.000.000	120.228.629	98.6 %
2	Shpenzime operative	18.400.000	18.370.248	99.8 %
3	Shpenzime për investime	500.000	330.000	66 %

Nr	Lloji i investimit	Vlera	Burimi i investimit	Shpjegime plotësuese
1	Mobilje zyre	500.000	Buxheti i shtetit	Përmirëson kushtet e punës të gjyqtarëve

Gjatë periudhës 06.11.2023-15.12.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, u krye auditimi i periudhës 01.01.2021 – 31.03.2023 me objekt auditimi:

Vlerësimi i funksionimit të kontrolleve të brendshme të projektuara dhe vendosura nga menaxhimi i gjykatës në funksion të realizimit të objektivave të veprimtarisë.

Qëllimi i auditimit: Dhënia e sigurisë objektive dhe të arsyeshme titullarit, mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së gjykatës me legjislacionin në fuqi, funksionimin e sistemeve të ngritura, mirëadministrimin dhe mirëmenaxhimin e tyre.

Konkluzioni i përgjithshëm i auditit mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, paraqet një performancë të mirë në menaxhimin e veprimtarisë gjyqësore, marrjen e vendimeve strategjike dhe operacionale, mbikëqyrjen e administrimit të riskut dhe kontrolleve, sigurimin dhe administrimin efektiv të punës organizative dhe përgjegjësi.

8. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me institucionet si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës me qëllim plotësimin e kërkesave dhe marrjen e masave për trajtimin e ankesave, kryerjen e procesit të hartimit dhe administrimit të statistikave dhe ndjekjen e trajnimit vazhdues të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore.

Edhe në vitin 2023 gjyqtarët kanë ndjekur trajnimet vazhduese të organizuara kryesisht nga Shkolla e Magjistraturës. Gjatë vitit 2023, është bërë e mundur përfaqësimi i viktimave me avokat falas në rastet kur e kërkojnë. Kjo në saj të bashkëpunimit me Dhomën Vendore të Avokatisë Fier në bazë të listës së avokatëve që kanë pranuar të ofrojnë ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje në gjykimet për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes. Me zbatimin e Ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” janë marra masa për orientimin, publikimin dhe vendosjes në dispozicion të formularëve për përfitimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Po ashtu, është ndjekur praktika e mëparshme për përcaktimin e listës së avokatëve kryesisht sipas një grafiku gadishmërie. Bashkëpunimi me institucionet e tjera vendore ka ndikuar pozitivisht në menaxhimin dhe qarkullimin e çështjeve gjyqësore.

Në vijimësi edhe gjatë vitit 2023, Gjykata ka patur bashkëpunim dhe mbështetje nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Dhoma Vendore e Avokatisë Fier, për marrjen e masave që lidhen me reduktimin e kërkesave për shtyrje të gjykimit, etj. Edhe me institucionet e tjera vendore si Komisariatet e Policisë Fier dhe Lushnje, Stacionet Policore Patos, Roskovec e Divjakë, I.E.V.P Fier, Zyra Postare Fier, Zyra e Përmbarrimit Fier dhe Lushnje, Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Fier ka vazhduar bashkëpunimi për masat e ndërmarra në kuadër të planit të veprimit siç janë: paraqitja e dokumentave të kërkuara përpara seancës, komunikimi i shpejtë me gjykatën edhe në rrugë elektronike, përmirësimi i mënyrës së kryerjes së njoftimeve, aplikimi i mënyrave alternative të njoftimit dhe komunikimit. Gjykata ka aplikuar komunikimin elektronik nëpërmjet postës elektronike e-mail edhe me avokatët apo palët si dhe me pjesëmarrësit/palët e treta në gjykim, apo me ekspertët, si dhe ka përmirësuar përmbajtjen e njoftimeve me qëllim njoftimin në të njëjtën kohë të palëve edhe me të

drejtat dhe detyrimet e tyre, si për t'Û mbrojtur me avokat përpara se të fillojë procesi gjyqësor, për të paraqitur prova etj.

Nga ana e gjykatës janë organizuar një sërë takimesh si me përfaqësues të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Dhomës Vendore të Avokatisë Fier, I.E.V.P Fier, etj. Gjithashtu janë zhvilluar takime me punonjës të Zyrës Postare Fier, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit postar gjyqësor dhe zgjidhjes së problematikave të shtyrjes së seancave për arsye të moskthimit në kohë të përgjigjeve, apo parregullsive në aktet e njoftimit. Gjykata ka mbikqyrrur progresin e çështjeve nëpërmjet takimeve të Këshillit të Gjykatës me përdoruesit e gjykatës si avokatë, prokurorë, shërbimin postar, konsultimet e Këshillit me mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve. Në mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve është diskutuar gjithmonë për shkaqet e shtyrjes së seancave dhe kohëzgjatjen e gjykimit dhe masat që duhet të merren në këtë drejtim.

Një rëndësi të madhe për përmirësimin e shërbimit gjyqësor ka patur edhe bashkëpunimi me organizata të ndryshme që operojnë në fushën e drejtësisë si USAID, OSCE, Zyra e përfaqësimit të KE në Shqipëri (CEPEJ), Euralius, Pameca, etj.

Në perfundim të analizës, duke Ju falenderuar për vëmendjen Tuaj, Ju urojmë të gjithëve suksese në punën Tuaj!

Ju faleminderit!

ZV.KRYETARE E GJYKATËS

OLKEDA LICE